



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)
Agencija za Investicije i Podršku Preduzeća na Kosovu (KIESA)
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency (KIESA)

Me qëllim të zvogëlimit të deficitit tregtar dhe përmirësimit të kapaciteteve prodhuese të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM), rritjen e investimeve, të eksportit, konkurrueshmërisë dhe hapjen e vendeve të reja të punës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) shpallë:

Thirrje publike për subvencionim me mjete financiare për NMVM

Bazuar në Udhëzimin Administrativ (MTI) nr. 01/2018 për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve, dhe me qëllim të ngritjes së kapaciteteve prodhuese, shpallim thirrje të hapur për përkrahjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme për blerjen e makinerisë prodhuese/përpunuese. MTI/KIESA do të mbështes në subvencionim me mjete financiare ndërmarrjet sipas kategorive të tyre, si në vijim:

- Për ndërmarrjet mikro (të punësuar 1 deri 9 punëtor), vlera totale e granateve do të jetë 250,000.00 EURO. Vlera maksimale që mund të përfitoj një ndërmarrje mikro është deri në 75% e vlerës së makinerisë ose në vlerë financiare maksimumi deri në 15,000.00 EURO;
- Për ndërmarrjet e vogla (të punësuar 10 deri 49 punëtor), vlera totale e granateve do të jetë 150,000.00 EURO. Vlera maksimale që mund të përfitoj një ndërmarrje e vogël është deri në 50% e vlerës së makinerisë ose në vlerë financiare maksimumi deri në 30,000.00 EURO;
- Për ndërmarrjet e mesme (të punësuar 50 deri 249 punëtor), vlera totale e granateve do të jetë 100,000.00 EURO. Vlera maksimale që mund të përfitoj një ndërmarrje e mesme është deri në 50 % e vlerës së makinerisë ose në vlerë financiare maksimumi deri në 50,000.00 EURO.

Aplikuesi i cili aplikon për subvencione dhe transfere në Ministri, duhet të jetë i regjistruar në Republikën e Kosovës.

1. Për të aplikuar duhet plotësuar Aplikacionin (*shkarko në web*) më të dhënat bazike të subjektit aplikues dhe duhet të dorëzoj dokumentacionin sipas UA (MTI) 01/2018 dhe kërkesave shtesë, si në vijim:
 - 1.1. Certifikatën e regjistrimit të biznesit me të gjitha informatat përcjellëse sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës;
 - 1.2. Certifikatën e numrit fiskale (nuk aplikohet për bizneset të cilat numrin e regjistrimit të biznesit dhe numrin fiskal e kanë në një certifikatë);
 - 1.3. Vërtetim tatimor me të cilën vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe aktuale tatimore të pushyera apo obligime tjera tatimore ose është në marrëveshje për shlyerjen e borxhit me ATK;
 - 1.4. Kopjen e letërnjoftimit të personit/ve në emër të cilit/ve është i regjistruar aplikuesi;
 - 1.5. Dëshmi nga aplikuesi se nuk është nën falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor të lëshuar nga Gjykata Themelore – kërkohet origjinali jo më i vjetër se 30 ditë;
 - 1.6. Dëshminë e xhirollogarisë aktive të aplikuesit në njërën prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovë;
 - 1.7. Gjendjen e xhirollogarisë bankare të aplikuesit për vitin e fundit. Për aplikuesin e sapo themeluar kjo nuk është e aplikueshme;
 - 1.8. Projekt-propozimin që përfshin: qëllimin, aktivitetet e projektit, koston financiare si dhe planin kohor të realizimit të projektit dhe strukturën organizative të aplikuesit;
 - 1.9. Të mos ketë pranuar mjete nga burimet tjera të financimit për të njëjtat aktivitet, (e dëshmuar më deklaratën nën betim);
 - 1.10. Të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit nga MTI për dy vitet e fundit, (e dëshmuar me deklaratën nën betim);
 - 1.11. Lista e të punësuarve të dëshmohet nga Administrata Tatimore e Kosovës për vitin 2019. Në bazë të së cilës listë do të kategorizohen si ndërmarrje mikro, e vogël dhe e mesme. Sqarim: kompanitë që kanë mbi 249 punëtor, diskualifikohen.
 - 1.12. Ndërmarrja me rastin e aplikimit duhet të dorëzojë ofertën për blerjen e makinerisë prodhuese/përpunuese.
 - 1.13. Vlera e bashkëfinancimit të vlerës së projektit investiv duhet të dëshmohet me dëshmi bankare (gjendja bankare e nënshkruar dhe e vulosur) apo me “letër referencë” nga banka (nënshkruar dhe vulosur), e cila dëshmon që do të bashkëfinancoj projektin e subjektit aplikues në rast që do të përfitoj subvencionimin në fjalë.

Sqarim: Ju lutem vini re se në mungesë të cilitdo dokument të kërkuar me lartë, subjektet aplikuese do të diskualifikohet dhe nuk do të shqyrtohet tutje për kriteret e vlerësimit të listuara më poshtë.

2. Kriteret e vlerësimit:

- 2.1 Të ardhurat bruto vjetore, marrin maksimum 20 pikë:
 - ndërmarrjet mikro marrin nga një (1) pikë për çdo 2,000.00 EUR të ardhura bruto vjetore,
 - ndërmarrjet e vogla marrin nga një (1) pikë për çdo 40,000.00 EUR të ardhura bruto,
 - ndërmarrjet e mesme marrin nga një (1) pikë për çdo 200,000.00 EUR të ardhura bruto.

Të ardhurat bruto të dëshmohen nga Administrata Tatimore e Kosovës për vitin 2019.

- 2.2 Vlera e bashkëfinancimit të vlerës së projektit investiv nga ana e ndërmarrjes (blerjes se makinerisë prodhuese/përpunuese), marrin maksimum 25 pikë:
 - ndërmarrjet mikro marrin nga tri (3) pikë për çdo 1,000.00 EUR të deklarimit të bashkëinvestimit të vlerës së projektit,
 - ndërmarrjet e vogla marrin nga një (1) pikë për çdo 1,200.00 EUR të deklarimit të bashkëinvestimit të vlerës së projektit,
 - ndërmarrjet e mesme marrin nga një (1) pikë për çdo 2,000.00 EUR të deklarimit të bashkëinvestimit të vlerës së projektit.

- 2.3 Planifikimi i punësimit, maksimum 30 pikë,
 - ndërmarrjet mikro marrin nga gjashtë (6) pikë për çdo një (1) që do të punësojnë;
 - ndërmarrjet e vogla marrin nga katër(4) pikë për çdo një (1) që do të punësojnë;
 - ndërmarrjet e mesme marrin nga dy (2) pikë për çdo një (1) që do të punësojnë;

Numri që planifikohet të punësohet duhet të dëshmohet me deklaratë me shkrim (nënshkruar dhe vulosur), e cila më pastaj për ndërmarrjet përfituese do të jetë pjesë e marrëveshjes.

- 2.4 Përqindja e të punësuarve të gjinisë femërore nga gjithsej të punësuarit e subjektit aplikues, maksimum dhjetë (10) pikë, nga një (1) pikë për çdo 10% të të punësuarve të gjinisë femërore.

Lista e të punësuarve të dëshmohet nga Administrata Tatimore e Kosovës për vitin 2019.

- 2.5 Maksimumi 15 pikë, me projekt-propozime dëshmojnë që subvencionet e ndara do të ndikojnë në:
 - Rritjen e investimeve në Republikën e Kosovës;
 - Rritjen e prodhimitarisë vendore;
 - Rritjen e eksportit;
 - Promovimin e turizmit;
 - Zhvillimin e NMVM-ve;
 - Rritjen e kapaciteteve konkurruese të NMVM-ve;
 - Hapjen e vendeve të reja të punës.

Vëmendje:

- ✓ Në rast që ndërmarrja do të jetë përfitues, atëherë do të nënshkruhet marrëveshje dypalëshe (MTI/KIESA dhe ndërmarrje), pjesë e secilës do të jenë edhe deklaratimet që janë bërë me rastin e aplikimit.
- ✓ TVSH është shpenzim i pranueshëm vetëm për persona fizik dhe ndërmarrje jo deklaruese të TVSH-së. Për ndërmarrjet që janë deklaruese të TVSH-së, ky është shpenzim i papranueshëm.
- ✓ Makinaria prodhuese/përpunuese e cila kërkohet të subvencionohet duhet të jetë e re.
- ✓ Ndërmarrjet mund të përfitojnë vetëm një grant dhe atë vetëm për makineri.
- ✓ Vlerësimi i aplikacioneve zhvillohet ndërmjet kategorive përkatëse si mikro me mikro, të vogla me të vogla dhe të mesmet me të mesme.
- ✓ Ndërmarrjet që nuk i kalojnë 50 pikë do të diskualifikohen.
- ✓ Përfitues do të jenë ato ndërmarrjet që janë renditur më pikë më të larta nga komisioni vlerësues, varësisht prej limiteve buxhetore të planifikuara.

Sqarim: NMVM-të që kanë përfituar subvencionim me mjete financiare për blerjen e makinerive gjatë vitit 2018 dhe 2019 nga MTI/KIESA nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga kjo thirrje.

Periudha e aplikimit:

Njoftimi për thirrje publike është i publikuar në ueb faqen e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë mti.rks-gov.net dhe KIESA-s kiesa.rks-gov.net. Subjektet që dëshirojnë të aplikojnë sipas thirrjes publike duhet të shprehin interesimin e tyre duke dorëzuar të gjithë dokumentacionin në zyrën e arkivit të Ministrisë në formë fizike dhe në CD, në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Rr. Muharrem Fejza, Lagjia e Spitalit, p. n. Prishtinë, 10000, Republika e Kosovës.

Afati i fundit për shprehje të interesit është deri më datë 14.07.2020 në orën 16:00 dhe aplikimet pas këtij orari nuk pranohen nga zyra e Arkivit të Ministrisë.

Informata dhe sqarime shtesë mund të merren përmes postës elektronike në: info.kiesa@rks-gov.net konform U.A.01/2018, por jo më vonë se pesë (5) ditë para mbylljes së thirrjes publike.